

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PRESEDNIKA/PRESIDENT'S OFFICE/BASKAN OFISI


Në bazë të nenit 78 të Statutit të Komunës së Gjiçlanit 01 nr. 016-126211 të dt. 06.11.2014 me ndryshimet dhe plotësimet ne statut 01. nr. 016-28448 të datës 22.03.2018, Kryetari Komunës së Gjiçlanit, merr këtë:

**VENDIM
PËR**


RREGULLIMIN E FAKSIMILIT TË RI TË KRYETARIT TË KOMUNËS DHE SHPALLJEN E PAVLEFSHME DHE ASGJËSIMIN E FAKSIMILIT TË VJETËR

1. Me këtë vendim rregullohet faksimili (nënshkrimi) i ri i kryetarit të Komunës së Gjiçlanit.
2. Shpallet i pavlefshëm faksimili (nënshkrimi) i deritashëm i kryetarit të Komunës së Gjiçlanit dhe i njëjti të asgjësohet fizikisht.
3. Rregullimi i faksimilit të ri të kryetarit të Komunës, bëhet në prezencën e tij dhe përpunuesi në prezencë të tij duhet t'i asgjësojë të gjitha modelet, kallëpet si dhe të gjitha gjurmët e tjera, të cilat kanë mbetur gjatë procesit të përpunimit të faksimilit.
4. Lidhur me pikën 2 të këtij vendimi të njoftohet vulëpunuesi, që të asgjësojë të gjitha modelet, kallëpet si dhe gjitha gjurmët tjera që kanë mbetur gjatë procesit të përpunimit të faksimilit.
5. Faksimili i kryetarit mund të përdoret vetëm me autorizimin e kryetarit të Komunës.
6. Asgjësimi i faksimilit të vjetër duhet të bëhet në prezencën e kryetarit dhe të hartohet procesverbal.
7. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës.
8. Me aktin e nënshkrimit ky vendim bëhet i plotfuqishëm.

02. nr. _____
Gjiçlan, _____




Kryetari i Komunës
Lutfi Haziri



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA - MAYOR'S OFFICE – BAŞKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të LVL-së nr. 03/L-040 dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës si dhe të Vendimit të Kuvendit të Komunës së Gjiçanit 01. nr. 016-134652 të datës 02.12.2014 për caktimin e lartësisë së kompensimit mujor për anëtarët e komisioneve komunale të aksionarëve, kryetari i komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR PAGESËN E KOMPENSIMIT PËR ANËTARËT E KOMISIONEVE TË
FORMUARA NGA KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

1. Anëtarët e komisionit komunal të aksionarëve në PPP “Ecohigjiena” për pjesën publike të KRM “Higjiena”.

1	Xhelal Jetishi	200,00€
2	Muhadin Haziri	200,00€
2	Fadil Gashi	200,00€
	TOTALI	600.00€

2. Kompensimi i anëtarëve të komisioneve do të bëhet për punën e kryer në takimet e komisioneve të aksionarëve për muajin Prill /2018 për kompanitë PPP“ Ecohigjiena” për pjesën publike të KRM “Higjiena”.
3. Kompensimi do të bëhet nga mjetet buxhetore për mallra dhe shërbime - Drejtoria për zhvillim ekonomik.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, ndërsa ekzekutimin e bënë Drejtoria për Buxhet dhe Financa.



Kryetari i Komunës

Lutfi Haziri

Vendimi i dorëzohet:

- DZHE dhe
- DBF-ja



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA - MAYOR'S OFFICE – BAŞKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të LVL-së nr. 03/L-040 dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës 01. nr. 016-126211 të datës 06.11.2014 si dhe në zbatim të Vendimit të Kuvendit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 016-84848 të datës 16.08.2017 për Caktimin e Lartësisë së Kompensimit Mujor për Anëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve NLP “Tregu”, Kryetari i Komunës së Gjilanit, merr këtë:

VENDIM
PËR PAGESËN E MJETEVE FINANCIARE PËR ANËTARET E KOMISIONIT
KOMUNAL TË AKSIONARËVE NË NLP "TREGU" SHA NË GJILAN

1. Me këtë vendim bëhet pagesa e mjeteve financiare për anëtarët e Komisionit të aksionarëve për muajin **Prill / 2018**, të si në vijim:

1	Driton Nuh	200,00 €
2	Albulena Asllani	200,00 €
2	Fidan Kadriu	150,00 €
	TOTALI	550.00 €

2. Pagesa e mjeteve financiare bëhet nga Kodi buxhetor mallra dhe shërbime të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomi duke u bartë në xhirollogarinë përkatëse të secilit aksionarë veç e veç.
3. Pjesë e këtij vendimi është vendimi i KK-së 01. nr. 016-84848 të datës 16.08.2017 për Caktimin e Lartësisë së Kompensimit Mujor për Anëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve NLP “TREGU” SHA në Gjilan dhe procesverbalet për takimet e mbajtura të komisionit të aksionarëve.
4. Për zbatimin e vendimit kujdeset Drejtoria për Zhvillim Ekonomik kurse ekzekutimin e tij e bënë Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Ky vendim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit të këtij vendimi

Vendimi i dorëzohet:


- Anëtarëve
- DZHE-së,
- Arkivit.



Kryetari i Komunës
Lufti Haziri



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA - MAYOR'S OFFICE – BAŞKAN OFISI

Në pajtim me nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës 01. nr. 016-126211 të dt. 06. 11. 2014 me ndryshimet dhe plotësimet 01. Nr. 016-28448 të datës 22.03.2018, Kryetari i Komunës nxjerrë këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me nr.49139 të datës 18.05.2018 për emërimin e komisionit për vlerësimin e ofertave **“Hartimi i projekteve Ideore dhe Kryesore në Komunën e Gjiçanit”** me numër të prokurimit **GL 651 18 023 221** .

1. Me këtë vendim bëhet ndryshimi i pikës 1, të vendimit me nr. nr. 49139 të datës 18.05.2018 për emërimin e komisionit për vlerësimin e ofertave:

“Hartimi i projekteve Ideore dhe Kryesore në Komunën e Gjiçanit”

Kimete Salihu – anëtare e komisionit për vlerësimin e ofertave, fshihet dhe shënohet **Edon Shkodra– Ing. nga DSHMP,**

2. Ndryshimi i vendimit vjen për arsye se anëtarja e komisionit është e angazhuar në trajnim dhe nuk mund të marrë pjesë gjatë punës së komisionit për vlerësimin e ofertave.
3. Detyrat dhe funksionet e të emëruarit **Edon Shkodra** anëtar i komisionit për vlerësimin e ofertave **“Hartimi i projekteve Ideore dhe Kryesore në Komunën e Gjiçanit” me numër të prokurimit GL 651 18 023 221** janë të ngjashme sikur në vendimin nr. 49139 të datës 18.05.2018.
4. Ky vendim hynë në fuqi me aktin e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe protokollimit të tij.

Vendimi i dorëzohet:

- Zyrës së Prokurimit,
- Arkiv



Kryetari i Komunës

Lutfi Haziri

Gjiçane, 30.05.2018



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT

KANCELARIJA PRESEDNIKA - MAYOR'S OFFICE – BAŞKAN OFISI

Në pajtim me nenin 13, e në zbatim të nenit 58 shkronja (f) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 28 e dt. 04 qershor 2008) dhe nenin 2 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 02/2014 - MAP nr. 01, Për Caktimin e Stafit Mbështetës në Komuna, Kryetari i Komunës nxjerr:

**V E N D I M
P Ë R**

**LIRIM NGA DETYRA E ASISTENTIT ADMINISTRATIV NË KABINETIN E
KRYETARIT TË KOMUNËS**

1. Me këtë vendim, z. Arben Haziri, LIROHET nga detyra Asistent administrativ në Kabinetin e Kryetarit të Komunës.
2. Lirimi nga detyra i të emëruarit nga pika 1 e këtij vendimi bëhet nga data 30.04.2018.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Njësia e personelit.
4. Vendimi hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës

Vendimi t’i dorëzohet:

- Të liruarit
- Njesisë së personelit





Kryetari i Komunës

Lutfi Haziri



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT

KANCELARIJA PRESEDNIKA - MAYOR'S OFFICE – BAŞKAN OFISI

Në pajtim me nenin 13, e në zbatim të nenit 58 shkronja (f) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 28, e dt; 04 qershor 2008) dhe nenin 2 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 02/2014 - MAP nr. 01, Për Caktimin e Stafit Mbështetës në Komuna, Kryetari i Komunës nxjerr:

V E N D I M PËR EMËRIMIN E ASISTENTËS ADMINISTRATIVE

1. **EMËROHET**, znj. Florentina Haliti Mehmeti, Asistente administrative në Kabinetin e Kryetarit të Komunës duke filluar nga data **01.06.2018**.
2. Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të emëruares nga pika 1 e këtij vendimi, përcaktohen nga Kryetari i Komunës duke u bazuar në legjislacionin përkatës të punës në fuqi, e të cilat janë të natyrës ndihmëse teknike administrative.
3. Paga mujore e të emëruares, caktohet në lartësi prej 280 € bruto në muaj në pajtim me nenin 3 paragrafi 1 nëparagrafi 1.1 të U.A- MAPL nr. 02 / 2014 MAP nr.01.
4. Orari i punës së të emëruarit caktohet nga vet Kryetari i Komunës
5. E emëruara nuk e ka statusin e nëpunësit civil, por statusin e stafit mbështetës të Kryetarit të Komunës.
6. Marrëdhënia e punës e të emëruares pushon me përfundimin e mandatit të Kryetarit të Komunës nëse kjo marrëdhënie e punës nuk ndërpritet më herët.
7. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Njësia e personelit.
8. Vendimi hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit të tij.

Vendimi t’i dorëzohet:

- Të emëruares
- Njesisë së personelit




Kryetari i Komunës

Lutfi Haziri



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PRESEDNIKA/PRESIDENT'S OFFICE/BASKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të LVL-së nr. 03/L-040, nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Gjilanit, me ndryshimet dhe plotësimet 01. nr. 016-28448 të datës 22.03.2018, Kryetari i Komunës së Gjilanit merr këtë:

**V E N D I M
P Ë R
EMËRIMIN E KOMISIONIT PËR SHËNIMIN E FESTAVE SHTETËRORE NË
KOMUNËN E GJILANIT**

1. Me këtë vendim emërohet komisioni për shënimin e festave shtetërore në Komunën e Gjilanit.
2. Komisioni ka këtë përbërje:
 - 2.1. Shpresa Kurteshi, kryetare
 - 2.2. Nazim Gagica, anëtar
 - 2.3. Naser Korça, anëtar
 - 2.4. Veton Shaqiri, anëtar
 - 2.5. Shpresa Hajdari, anëtare
 - 2.6. Exhevit Rexhepi, anëtar
 - 2.7. Shqipe Hajdini, anëtare
3. Komisioni ka për detyrë ta bëjë programin e plotë të aktiviteteve, mënyrën e organizimit, masat e marra, listën e të ftuarve, kohën dhe vendin e caktuar. Përgatitja e aktivitetit rreth shënimit të festave bëhet paraprakisht.
4. Komisioni do t'i raportoj Kryetarit të Komunës së Gjilanit.
5. Ky vendim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

- Anëtarëve
- Arkivit.



Kryetari i Komunës
Lutfi Haziri



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA-MAYOR'S OFFICE-BAŞKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të LVL, nr. 03/L-040 dhe nenit 78 të Statutit të Komunës të Gjiçanit, Kryetari i Komunës në cilësinë e Organit më të lartë administrativ dhe punëdhënës në zbatim të nenit 90 paragrafi 2 nënparag. 2.1, nenit 91 paragrafi 1 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr. 03/L-149 dhe nenit 11 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 të Rregullores nr. 01/2011 për Ndërprerjen, Pezullimin dhe Përfundimin e Marrëdhënies së Punës në Shërbimin Civil të Kosovës, nxjerr këtë:

V E N D I M
P Ë R
P Ë R F U N D I M I N E M A R R Ë D H Ë N I E S S Ë P U N Ë S

1. Nëpunësit civil, **z. Shyqeri Rexhepi** i lindur më: **18.06.1953**, i caktuar në detyra të punës, **Zyrtar për furnizim** në kuadër të **Drejtorisë për Arsim i Përfundon** punësimi në Shërbimin Civil Komunal më: **18.06.2018** sipas fuqisë së ligjit - **Pensionimi**.
2. Nëpunësit civil të pensionuar i takon e drejta e një page shtesë për pensionim në shumë prej një page mujore të njehershme në vlerë të pagës së fundit para pensionimit.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, **z. Shyqeri Rexhepi** i caktuar në detyra punuese **Zyrtar për furnizim** në kuadër të **Drejtorisë për Arsim** ka arritur moshën **65** vjeçare, moshën e pensionit më datë; **18.06.2018** dhe sipas Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës është caktuar shkuarja në pensionin e merituar me të drejtën e pagesës së një page shtesë për shkak të pensionimit.

Organi i punësimit, pas shqyrtimit të shkresave në dosjen personale të të punësuarit, konstatoi se; nëpunësi civil ka arritur moshën e pensionimit, andaj në bazë të nenit 90 paragrafi 2 nënparagrafi. 2.1, nenit 91 paragrafi 1 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr. 03/L-149, nenit 11 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 të Rregullores nr. 01/2011 për Ndërprerjen, Pezullimin dhe Përfundimin e Marrëdhënies së Punës në Shërbimin Civil dhe nenin 19 të Rregullores nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensimet të tjera të Nëpunësve Civil, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankesë komisionit të ankesave, brenda autoritetit komunal në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimit. Ankesa nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit.

VENDIMI T'I DORËZOHET:

- DA
- Nëpunësit civil
- Njësisë së personelit

